

z. Ymer Fejzullahu  
Kryesues i Bordit të ZRRE  
Zyra e Rregullatorit të Energjisë



Nr. 1178/22  
Data 23.11.22

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA KOSTT d.d

Nr. 2352 dt. 22.11.2022  
PRISHTINE-A

22 nëntor 2022

## Shqyrtimi Periodik për OST/OT- Tarifa e tretë shumëvjeçare (2023-2027) Aplikacioni për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)

I nderuar z. Fejzullahu,

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi si dokumentin iniciues të datës 26 Maj 2022 të ZRrE-së për Shqyrtimin e Tretë Periodik për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të licencuarve të OST/OT dhe OSSH për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2027, KOSTT ka përgatitur propozimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për 2023-2027.

Të bashkëngjitur me këtë shkresë mund të gjeni këto dokumente:

221122\_KOSTT\_Aplikacioni për Të Hyra 2023-2027  
221122\_KOSTT\_Templatë OST\_OT  
221122\_KOSTT\_Planet e shpenzimeve operative 2023-2027

Lusim Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesave të KOSTT për propozimet për periudhën 2023-2027.

Singerisht,



Fëllënëza Xhelili Fiqi  
Drejtore i Departamentit për  
çështje Rregullative dhe Tarifa



Cc:

- z. Selman Hoti, Anëtar i Bordit të ZRrE;
- z. Izet Rushiti, Anëtar i Bordit të ZRrE;
- z. Gani Buqaj, Anëtar i Bordit të ZRrE;
- znj. Lutfije Dervishi, Anëtare e Bordit të ZRrE;
- z. Petrit Pepaj, Drejtore Menaxhues i ZRrE;
- z. Ymer Rudari, zv. Udhëheqës i Departamentit për Tarifa në ZRrE;



22.11.2022

**Shqyrtimi Periodik për OST/OT**

**Tarifa e tretë shumëvjeçare (2023-2027)**

**Propozimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)**

Prishtinë,

## Përmbajtja

Lista e Tabelave.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Përmbledhje e përgjithshme .....	4
3. Të arriturat e KOSTT për periudhën 2013-2017 .....	5
4. Shpenzimet kapitale .....	7
5. Total shpenzimet operative.....	7
5.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes .....	8
5.2 Shpenzimet tjera operative.....	9
5.3 Rritja e numrit të stafit.....	10
6. Humbjet në transmetim .....	12
7. Shërbimet Ndhmëse .....	12
8. Fondi për BRE.....	13
9. Përfundim .....	14

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1. Të hyrat e lejuara për OST/OT-në gjatë shqyrtimit periodik dhe përshtatjeve të rregullta si dhe realizimi i tyre

Tabela 2. Zhvillimet në rrjetin e transmetimit 2018-2022

Tabela 3. Shpenzimet e lejuara dhe shpenzimet e realizuara 2018-2022

Tabela 4. Total shpenzimet operative 2023-2027

Tabela 5. Mirëmbajtja e lejuar dhe e realizuar 2018-2022

Tabela 6. Propozimi për mirëmbajtje 2023-2027

Tabela 7. Shpenzimet tjera operative 2018-2022

Tabela 8. Shpenzimet tjera operative 2023-2027

Tabela 9. Kërkesat për rritje të numrit të stafit

Tabela 10. Humbjet e parashikuara në transmetim 2023-2027

Tabela 11. Shërbimet ndihmëse 2023-2027

Tabela 12. Kostoja e rezervave 2023

Tabela 13. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit 2018-2022

Tabela 14. Parashikimet për Fondin e BRE 2022-2027

## 1. Hyrje

KOSTT me datën 16 maj 2022, ka pranuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Dokumentin Inicues të Shqyrtimit Periodik për OST/OT-në dhe OSSH-në, për periudhën 2023-2027.

Ky dokument bazuar në Ligjet për Energji të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe Rregullat dhe Metodologjitë si pjesë e legjislacionit sekondarë ka përcaktuar rrjedhën dhe afatet kohore të këtij procesi.

Si vazhdimësi e këtij procesi KOSTT me këtë dokument paraqet pjesën narrative të Aplikacionit për HML duke përfshirë në të sqarimet dhe faktet që arsyetojnë gjendjen aktuale dhe kërkesat për periudhën që vjen.

Gjithashtu, aplikacionit i bashkëngjiten Formularët Raportues të plotësuar sipas kërkesës së ZRRë.

## 2. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datë 24 shtator 2018 me anë të vendimit V\_1028\_2018, ka aprovuar të hyrat e lejuara pesëvjeçare për periudhën 2018-2022.

Vlera totale e lejuar për të hyrat e OST/OT-së për këtë periudhë ishte duke mos përfshirë të hyrat për Fondin për BRE kanë qenë 148,808,655 €, kurse pas procesve të përshtatjeve të rregullta kjo vlerë ka arritur në 159,933,602 €.

Tabela 1. Të hyrat e lejuara për OST/OT-në gjatë shqyrtimit periodik dhe përshtatjeve të rregullta si dhe realizimi i tyre

2018-2022	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Hyrat e Lejuara gjatë Shqyrtimit Periodik	€'000	27,603.881	28,746.972	29,970.109	30,951.404	31,536.290	148,808.655
Të Hyrat e Lejuara pas Përshtatjeve të Rregullta	€'000	27,603.881	40,452.599	28,103.624	28,834.573	34,938.925	159,933.602
Të Hyrat e Realizuara	€'000	14,449.712	37,365.572	32,773.000	30,433.000	34,867.000	149,888.284

Bazuar në legjislacionin primarë dhe sekondarë ekzistues në Republikën e Kosovës, struktura e këtyre të hyrave përbëhet nga blloqet e shpenzimeve operative, shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve tjera për të cilat do të ketë sqarime në vazhdim të dokumentit.

### **3. Të arriturat e KOSTT për periudhën 2013-2017**

KOSTT që nga themelimi në vitin 2006, si rrjedhojë e shturjes nga kompania vertikalisht e integruar, ka shënuar arritje të jashtëzakonshme duke dëshmuar se është hallka më e rëndësishme dhe e shëndetshme e sistemit të energjisë elektrike të Kosovës dhe një nga sistemet më efikase dhe më të qëndrueshëm në rajon.

Për vite me radhë, KOSTT ka vazhduar performancën pozitive të afarizmit e cila është karakterizuar me zhvillime të shumta, si në aspektin zhvillimor ashtu edhe në çështjet e integriteteve rajonale dhe evropiane.

- Më 01.02.2018, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ka lëshuar Opinionin me Nr.02/2019 lidhur me Certifikimin e KOSTT të nxjerrë në pajtim me nenin 3(1) Rregullores (EC) Nr.714/2009, dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72.
- Ndërtimi i Nënstacionit 110/10(20)kV Ilirida dhe Linjës së Dyfishtë Kabllore Nëntokësore Transmetuese 110 kV
- Ndërtimi i Nënstacionit 220/10(20)kV Drenasi dhe Linjës së Dyfishtë Transmetuese 220kV
- Ndërtimi i Nënstacionit 110/10 (20) kV Dardania (Prishtina 6) dhe Linjës së Dyfishtë Kabllore Nëntokësore Transmetuese 110 kV, linja e parë e këtij lloji në Kryeqytet.
- Zyra e Rregullatorit për Energji me 15 shkurt 2019, mori vendimi final për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST – KOSTT)
- Suksesi i radhës dhe momenti historik për KOSTT, e cila është nënshkrimi i Marrëveshjes për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK) me 26 nëntor 2019.
- Me 30 qershor 2020 u nënshkrua Marrëveshja e Kycjes KOSTT/ENTSO-E duke i hapur rrugë pavarësimit energjetik të KOSTT.
- Me datë 14 dhjetor 2020 përfundimisht KOSTT u shkëput nga Blloku SMM dhe filloi operimin e pavarur si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë (Blloku AK) duke krijuar kështu kushte të përshtatshme për shfrytëzimin optimal të burimeve gjeneruese brenda Bllokut AK.



- Për herë të parë në historinë e sektorit të energjisë të Republikës së Kosovës filloi alokimi i kapaciteteve interkonektive (ndërshtetërore) nën mbikëqyrje nga KOSTT dhe inkasimi i të hyrave nga shitja e tyre
- U funksionalizua nga aspekti komercial linja interkonektive e tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri, investim i përbashkët me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW ndërtimi i së cilës ka përfunduar që në vitin 2016.
- U themelua Bursa Shqiptare e Energjisë-ALPEX që shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë. Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri, përmes së cilit do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapaciteteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore të të dyja vendeve, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Të gjitha këto aktivitete të KOSTT janë në përputhje me objektivat strategjike, që janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
2. Mirëmbajtja dhe operimi i sigurtë dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit;
3. Krijimi i kushteve për një treg të liberalizuar dhe të integruar të energjisë elektrike;
4. Implementimi i tregut të organizuar një ditë para dhe benda ditor;
5. Implementimi i tregut balancues të energjisë elektrike;
6. Sigurimi i stabilitetit financiar të kompanisë;
7. Operimi si zonë e pavarur rregulluese/ në kuadër të bllokut AK në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale;
8. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
9. Avancimi i partneritetit me palët e interesit;
10. Të jetë punëdhënës atraktiv, duke siguruar barazinë gjinore dhe që investon në zhvillimin profesional të punonjësve, të talenteve dhe në avancimin e dijes;
11. Të jetë kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, në aspektin social dhe mjedisor;
12. Të krijojë një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune;
13. Menaxhimi i cilësisë dhe avancimi i kompanisë sipas standardeve ISO;
14. Rritja e të hyrave nga shërbimet për shfrytëzim të infrastrukturës së sistemit të telekomit dhe nga shërbimet tjera sekondare;
15. Akomodimi i kycjeve të reja në rrjetin e transmetimit;

#### 16. Kontribuoj në mbarëvajtjen e punës për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI).

Objektivat e lartpërmendura, para së gjithash, kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT është një kompani efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Sa i përket zhvillimit të rrjetit të dhënat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 2. Zhvillimet në rrjetin e transmetimit 2018-2022

2018-2022	Njësia	2017	2022
Kapaciteti N	MW	1,700	1,800
Kapaciteti N-1	MW	1,160	1,300
Linjat 110 kV	km	842	892
Linjat 220 kV	km	232	239
Transformatorët në kufi me KEDS	MW	2,080	2,320

## 4. Shpenzimet kapitale

Të dhënat dhe arsyetimet për shpenzime kapitale do ia bashkëngjisim versionit final të Planit Investues Pesëvjeçar.

## 5. Total shpenzimet operative

Për periudhën pesëvjeçare 2018-2022, KOSTT-it i janë lejuar 36,586,685 € të hyra në emër të shpenzimeve operative, ku hyjnë shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, shpenzimet e personelit, shpenzimet e shërbimeve komunale dhe shpenzimet tjera operative.

Tabela 3. Shpenzimet e lejuara dhe shpenzimet e realizuara 2018-2022



Total Shpenzimet Operative	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Shpenzimet e Lejuara Pas Faktorit të Efikasitetit	€'000	7,423.249	7,424.537	7,281.239	7,110.334	7,347.326	36,586.685
Shpenzimet e Realizuara	€'000	6,563.709	7,166.804	8,085.643	7,524.981	7,139.699	36,480.837
Ndryshimi	€'000	859.540	257.733	(804.404)	(414.646)	207.626	105.849

Tabela 4. Total shpenzimet operative 2023-2027

Total Shpenzimet Operative	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	Total
Propozimi	€'000	10,302.180	11,271.144	11,775.228	12,344.953	13,341.936	59,035.441

Më tutje janë paraqitur të dhënat dhe sqarimet në vazhdim.

## 5.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes

KOSTT për buxhetin e mirëmbajtjes për vitet 2018-2022 ka pasur të lejuara 5,253,661 € kurse janë realizuar 3,360,342.

Tabela 5. Mirëmbajtja e lejuar dhe e realizuar 2018-2022

Shpenzimet e Mirëmbajtjes	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Lejuara	€'000	1,077.000	1,077.187	1,056.397	1,029.258	1,013.819	5,253.661
Të Realizuara	€'000	493.690	684.050	752.920	826.682	603.000	3,360.342
Ndryshimi	€'000	583.310	393.137	303.477	202.576	410.819	1,893.320

Të gjitha planet e parashikuara të mirëmbajtjes si dhe ato të paparashikuara vit për vit realizohen mbi 95%. Mirëmbajtja kryhet sipas Rregullores së Mirëmbajtjes e cila është bazuar në standarde ndërkombëtare.

Mirëpo, niveli i ulët i paraqitur në pasqyra financiare diktohet nga dy faktorë. E para është se një pjesë e mirëmbajtjes në pasqyra financiare paraqitet te stoqet dhe një pjesë tjetër te investimet kapitale. E para është për shkak se të gjitha pjesë rezervë e që janë pjesë e planit të mirëmbajtjes evidentohen si stoqe deri sa të jenë të pa aktivizuara, si dhe e dyta disa pjesë rezervë që sigurohen me buxhetin e mirëmbajtjes në rast se e tejkalojnë vlerën prej 5% të asetetit që i bashkëngjitet evidentohet si investim kapital. Këto janë dy elementet ndikuese në nivelin e raportuar të mirëmbajtjes.

Mirëmbajtja e realizuar është preventive dhe e planifikuar. Disponueshmëria e rrjetit të transmetimit është e lartë edhe përkundër rritjes së aseteve me realizimin e investimeve kapitale . Indikatorët e prishjeve dhe rënive të elementeve të sistemit janë në nivel të ulët. Numri i intervenimeve emergjente është mjaft i vogël e që ndikon në zvogëlimin e kostos së mirëmbajtjes.

Sa i përket propozimit për mirëmbajtjen 2023-2027, ajo paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 6. Propozimi për mirëmbajtje 2023-2027

Shpenzimet e Mirëmbajtjes	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
Propozimi	€'000	1,023.813	1,188.245	1,061.245	1,144.585	1,150.585

Planin e detajuar të mirëmbajtjes mund ta gjeni të bashkëngjitur me këtë dokument.

## 5.2 Shpenzimet tjera operative

Për periudhën 2018-2022 për kategorinë e shpenzimeve tjera operative të KOSTT janë lejuar 31,313.964 € kurse janë realizuar 33,120.495 €. Ky tejkalim i shpenzimeve ka ndodhur si pasojë e nivelit shumë të ulët të lejuar për këtë kategori.

Siç mund të shihet edhe nga tabela në vazhdim aplikimi i faktorit të efikasitetit ndaj KOSTT ka dëmtuar operimin financiar të kompanisë.

Tabela 7. Shpenzimet tjera operative 2018-2022

Shpenzimet tjera operative	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Lejuara	€'000	6,346.249	6,347.351	6,224.843	6,062.016	6,333.506	31,313.964
Të Realizuara	€'000	6,070.019	6,482.754	7,332.723	6,698.299	6,536.699	33,120.495
Ndryshimi	€'000	276.230	(135.403)	(1,107.881)	(636.283)	(203.193)	(1,806.530)

Në këtë kategori të shpenzimeve hyjnë: shpenzimet e stafit, sigurimi shëndetësor, shërbimet komunale, udhëtimet zyrtare, trajnimet, telefoni, derivate, sigurimi fizik, furnizimi me materiale, përkthime, provizione bankare, shpenzime kadastrale, shërbime juridike, publikime, auditim, internet, kompenzim të dëmeve, paisje për mbrojtje në punë, shërbimet për CAO, shpenzimet për taksa, shpeditim, pagesa ARKEP, shpenzime përmbartimore dhe shumë shpenzime tjera.

Duke u bazuar në trendin aktual të inflacionit shpenzimet e parashikuara për këtë kategori kanë marrë parasysh një rritje për 10 % në vitin a parë për të reflektuar pjesërisht rritjen e çmimeve aktuale në treg si dhe viteve tjera një rritje e vogël për ta përcjellur trendin.

Kjo rritje është përfshirë gjithashtu me qëllim të mbajtjes së stafit profesional duke marrë parasysh se dukuria e ikjes së stafit e cila e ka përfshirë të gjithë vendin e ka prekur edhe KOSTT-in.

KOSTT ka arritur një nivel të lartë në ngritjen e cilësisë së kompanisë, parametrave teknik dhe financiar, qëndrueshmëri financiare, reputacion në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Si rezultat i kësaj KOSTT ka arritur të siguroj financim të projekteve nga donatorët dhe qasje në institucione kredibile financiare ndërkombëtare si KFW, BERZH.

KOSTT sa i përket performancës teknike, sigurisë së furnizimit, humbjeve në rrjet etj. mund të krahasohet me OST-të evropiane dhe gjithë kjo është arritur falë punës, përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të vet andaj edhe rritja e buxhetit për staf është qenësore për vazhdimin e mbajtjes dhe ngritjen e kualitetit me shërbimet që i përkasin së OST.

Tabela. 8 Shpenzimet tjera operative 2023-2027

Shpenzimet tjera operative	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	Total
Propozimi	€'000	9,278.367	10,082.899	10,713.983	11,200.368	12,191.351	53,466.968

### 5.3 Rritja e numrit të stafit

Gjatë periudhës tarifore 2018-2022 numri i përgjithshme i lejuar i stafit për KOSTT ka qenë 381.

Bazuar në rritjen e numrit të aseteve, rritjes së vëllimit të punës, kërkesa shtesë pas marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, punës si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Shqipëri – Kosovë (AK), rritjes së sigurisë kibernetike, paraqitet nevoja për rritjen e numrit të përgjithshme të punëtorëve për përudhen tarifore 2023-2027.

Arsyet kryesore për rritjen e numrit të punëtorëve për periudhën tarifore 2023-2027 janë:

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes se kyçjes me ENTSO-e dhe operimit të pavarur si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri, janë shtuar kërkesa të reja ndërlidhur me Bllokun rregullues AK dhe me raportimin dhe plotësimin e platformave në kuadër ENTSO-E. Skedulimi dhe shkëmbimi i fajllave për sigurinë e sistemit në qendrën koordinuese (RSC) dhe TSO evropiane nga Qendra Nacionale Dispecerike. Këto kërkesa kryesisht kanë ndikim në rritjen e numrit të stafit në Operatorin e Sistemit.
- Zhvillimi i projekteve ka ndikuar në rritjen e aseteve fizike si: rritja e numrit të nënstacioneve të reja, shtimi i gjatësisë së linjave të tensionit të lartë, rritja e numrit të transformatorëve energjetike dhe stabilimenteve dhe pajisjeve tjera përcjellëse duke rritur vëllimin e punës për stafin aktual. Krahas rritjes së aseteve fizike nuk ka ndodhur edhe rritja e numrit të stafit përkatës. Rritja e aseteve kryesisht ndikojnë në rritjen e numrit të stafit të Operatorit të Transmisionit dhe Departamentit të Shërbimeve Përkrahëse në kuadër të Drejtorisë Qendrore.
- Sipas udhëzuesit për zbatimin e marrëveshjes për energji parashihet integrimi i nënstacionit 110/x kV/kV Vallaq. Integrimi i NS Vallaqit ndikon në rritjen e numrit të stafit të Operatorit të Transmisionit.
- Zhvillimi i sektorit të energjisë, përkatësisht rritja e kontratave të operatorëve dhe BRE në tregun e energjisë elektrike në Kosovë. Kjo ndikon kryesisht në rritjen e stafit të Operatorit të Tregut.
- Plotësimi i kërkesa të reja pas certifikimit me standardin ISO 27001, dhe rritja e sigurisë kibernetike. Kërkesa kanë ndikim në rritjen e numrit të stafit në Departamentit të Shërbimeve Përkrahëse në kuadër të Drejtorisë Qendrore.

Tabela.9 Kërkesat për rritje të numrit të stafit

Numri i stafit i planifikuar për periudhën 2023-2027	Lejuar 2018-2022	2023	2024	2025	2026	2027
TO	220	234	239	239	239	247
SO	30	34	38	38	38	38
MO	18	18	18	19	19	19
HQ	113	118	127	127	127	127
KOSTT	381	404	422	423	423	431



## 6. Humbjet në transmetim

Sa i përket humbjeve të realizuara në raport me humbjet e lejuara KOSTT gjatë çdo procesi të përshtatjeve të rregullta ka raportuar në mënyrë të detajuar. Sa për ilustrim në vazhdim paraqitet tabela me vlera të parashikuara të kostos për periudhën 2023-2027.

Tabela 10. Humbjet e parashikuara në transmetim 2023-2027

Viti	2023	2024	2025	2026	2027
Humbjet GWh	139	129	129	130	132
Çmimi €/MWh	151	171	170	177	190
Pagesa e humbjeve (€'000)	21,058	22,059	21,981	23,055	25,040

## 7. Shërbimet Ndhimëse

Tabela 11. Shërbimet ndihmëse 2023-2027

Shërbimet ndihmëse 2023-2027	2023	2024	2025	2026	2027
Kostoja totale '000€	13,000.000	15,000.000	18,000.000	18,000.000	18,000.000

Aktualisht KOSTT në përputhje me Marrëveshjen e Kycjes me RGCE\ENTSO-E, është duke operuar si LFC Zonë e pavarur. Në kontekst të kësaj, ENTSO-E në vazhdimësi do të monitoron përmbushjen e kushteve teknike të KOSTT për operim të pavarur si LFC Zonë (LFC Area).

Një nga kërkesat me prioritet të lartë është sigurimi i shërbimeve ndihmëse për të balancuar sistemin elektroenergjetik të Kosovës në kohë reale.

Bazuar në përshkrimet e cekura më lart KOSTT obligohet që të siguroj blerjen e shërbimeve ndihmëse për balancimin e sistemit, konkretisht:

1. Rregullimin terciar (+/- mFRR Manual Frequency Restoration Reserves):

KOSTT është i obliguar të siguroj rregullimin terciarë për ngritje (+mFRR – pozitive Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën +150 MW dhe rregullimin terciarë për zbritje (-mFRR – negativ Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën -30 MW, sasi këto që nevojiten për balancimin e SEE të

Kosovës me rastin e paraqitjes së mungesave dhe tepricave të en.el. në SEE të Kosovës.

Kalkulimi për kostot e kapacitetit për rregullimin terciar mFRR në ngritje (150 MW) dhe zbritje të kapacitetit prej (-30 MW), si dhe rregullim sekondar aFRR +/-25MW (Automatic Frequency Restoration Reserves), për vitin 2023 është paraqitur si në tabelën e mëposhtme, gjithashtu edhe vitet në vijim janë llogaritur në të njëjtën mënyrë.

Tabela 12. Kostoja e shërbimeve ndihmëse 2023

Muaji	Kapacitet i (MW)	Ditë/Muaj	aFRR ngritje (çmimi 16.37 €)	aFRR zbritje (çmimi 10.0 €)	mFRR ngritje (çmimi 5.0 €)	mFRR zbritje (çmimi 2.4 €)	Gjithsej
Janar	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	53,568.00 €	1,102,067.16 €
Shkurt	25	28	275,031.50 €	168,000.00 €	504,000.00 €	50,400.00 €	997,431.50 €
Mars	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Prill	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Maj	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Qershor	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Korrik	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Gusht	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Shtator	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Tetor	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Nëntor	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Dhjetor	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Total			3,585,232.02 €	2,190,000.00 €	6,570,000.00 €	654,768.00 €	13,000,000.02 €

## 8. Fondi për BRE

Fondi për BRE është trajtuar ndaras nga të hyrat e KOSTT duke u bazuar në faktin se ky fond nuk vetëm menaxhohet nga KOSTT dhe nuk është e hyrë e vet. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat e realizuara si dhe parashikimet për 5 vitet e ardhshme.

Tabela 13. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit 2018-2022



Fondi për BRE Realizimi	2018	2019	2020	2021	2022
Të hyrat €'000	10,114.934	18,289.389	25,046.069	29,662.300	42,682.000
Fondi €'000	9,026.350	15,673.593	18,637.785	23,129.250	38,364.000
Ndryshimi €'000	1,088.584	2,615.795	6,408.284	6,533.050	4,318.000

Tabela 14. Parashikimet për Fondin e BRE 2022-2027

Fondi për BRE Parashikimi	2023	2024	2025	2026	2027
Fondi €'000	47,939.695	50,336.680	120,710.885	152,331.655	371,603.448

## 9. Përfundim

Në tabelën në vijim është paraqitur përmbledhja e kërkesave për kostot operative të KOSTT, për periudhën e tretë rregullative 2023-2027.

Tabela 15. Kërkesa për kostot operative 2023-2027

Kërkesa për kostot operative 2023-2027	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	2023-2027
Mirëmbajtje	€'000	1,023.813	1,188.245	1,061.245	1,144.585	1,150.585	5,568.473
Shpenzime tjera operative	€'000	9,278.367	10,082.899	10,713.983	11,200.368	12,191.351	53,466.968
Humbje	€'000	21,058.460	22,059.000	21,981.210	23,054.750	25,040.293	113,193.713
Shërbime ndihmëse	€'000	13,000.000	15,000.000	18,000.000	18,000.000	18,000.000	82,000.000
Total	€'000	44,360.640	48,330.144	51,756.438	53,399.703	56,382.229	254,229.155

Duke marrë parasysh rëndësinë e KOSTT si nyje e sektorit elektroenergjetik të Kosovës, operimi efikas dhe i pavarur është i domosdoshëm i cili lidhet ngushtë me aprovimin e këtyre kërkesave.



22.11.2022

**Shqyrtimi Periodik për OST/OT**

**Tarifa e tretë shumëvjeçare (2023-2027)**

**Propozimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)**

Prishtinë,

## Përmbajtja

Lista e Tabelave.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Përmbledhje e përgjithshme .....	4
3. Të arriturat e KOSTT për periudhën 2013-2017 .....	5
4. Shpenzimet kapitale .....	7
5. Total shpenzimet operative .....	7
5.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes .....	8
5.2 Shpenzimet tjera operative .....	9
5.3 Rritja e numrit të stafit.....	10
6. Humbjet në transmetim .....	12
7. Shërbimet Ndhmëse .....	12
8. Fondi për BRE.....	13
9. Përfundim .....	14

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1. Të hyrat e lejuara për OST/OT-në gjatë shqyrtimit periodik dhe përshtatjeve të rregullta si dhe realizimi i tyre

Tabela 2. Zhvillimet në rrjetin e transmetimit 2018-2022

Tabela 3. Shpenzimet e lejuara dhe shpenzimet e realizuara 2018-2022

Tabela 4. Total shpenzimet operative 2023-2027

Tabela 5. Mirëmbajtja e lejuar dhe e realizuar 2018-2022

Tabela 6. Propozimi për mirëmbajtje 2023-2027

Tabela 7. Shpenzimet tjera operative 2018-2022

Tabela 8. Shpenzimet tjera operative 2023-2027

Tabela 9. Kërkesat për rritje të numrit të stafit

Tabela 10. Humbjet e parashikuara në transmetim 2023-2027

Tabela 11. Shërbimet ndihmëse 2023-2027

Tabela 12. Kostoja e rezervave 2023

Tabela 13. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit 2018-2022

Tabela 14. Parashikimet për Fondin e BRE 2022-2027

## 1. Hyrje

KOSTT me datën 16 maj 2022, ka pranuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Dokumentin Inicues të Shqyrtimit Periodik për OST/OT-në dhe OSSH-në, për periudhën 2023-2027.

Ky dokument bazuar në Ligjet për Energji të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe Rregullat dhe Metodologjitë si pjesë e legjislacionit sekondarë ka përcaktuar rrjedhën dhe afatet kohore të këtij procesi.

Si vazhdimësi e këtij procesi KOSTT me këtë dokument paraqet pjesën narrative të Aplikacionit për HML duke përfshirë në të sqarimet dhe faktet që arsyetojnë gjendjen aktuale dhe kërkesat për periudhën që vjen.

Gjithashtu, aplikacionit i bashkëngjiten Formularët Raportues të plotësuar sipas kërkesës së ZRrE.

## 2. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datë 24 shtator 2018 me anë të vendimit V\_1028\_2018, ka aprovuar të hyrat e lejuara pesëvjeçare për periudhën 2018-2022.

Vlera totale e lejuar për të hyrat e OST/OT-së për këtë periudhë ishte duke mos përfshirë të hyrat për Fondin për BRE kanë qenë **148,808,655 €**, kurse pas procesve të përshtatjeve të rregullta kjo vlerë ka arritur në **159,933,602 €**.

Tabela 1. Të hyrat e lejuara për OST/OT-në gjatë shqyrtimit periodik dhe përshtatjeve të rregullta si dhe realizimi i tyre

2018-2022	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Hyrat e Lejuara gjatë Shqyrtimit Periodik	€'000	27,603.881	28,746.972	29,970.109	30,951.404	31,536.290	148,808.655
Të Hyrat e Lejuara pas Përshtatjeve të Rregullta	€'000	27,603.881	40,452.599	28,103.624	28,834.573	34,938.925	159,933.602
Të Hyrat e Realizuara	€'000	14,449.712	37,365.572	32,773.000	30,433.000	34,867.000	149,888.284

Bazuar në legjislacionin primarë dhe sekondarë ekzistues në Republikën e Kosovës, struktura e këtyre të hyrave përbëhet nga blloqet e shpenzimeve operative, shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve tjera për të cilat do të ketë sqarime në vazhdim të dokumentit.

### 3. Të arriturat e KOSTT për periudhën 2013-2017

KOSTT që nga themelimi në vitin 2006, si rrjedhojë e shturjes nga kompania vertikalisht e integruar, ka shënuar arritje të jashtëzakonshme duke dëshmuar se është hallka më e rëndësishme dhe e shëndetshme e sistemit të energjisë elektrike të Kosovës dhe një nga sistemet më efikase dhe më të qëndrueshëm në rajon.

Për vite me radhë, KOSTT ka vazhduar performancën pozitive të afarizmit e cila është karakterizuar me zhvillime të shumta, si në aspektin zhvillimor ashtu edhe në çështjet e integriteteve rajonale dhe evropiane.

- Më 01.02.2018, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ka lëshuar Opinionin me Nr.02/2019 lidhur me Certifikimin e KOSTT të nxjerrë në pajtim me nenin 3(1) Rregullores (EC) Nr.714/2009, dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72.
- Ndërtimi i Nënstacionit 110/10(20)kV Ilirida dhe Linjës së Dyfishtë Kabllore Nëntokësore Transmetuese 110 kV
- Ndërtimi i Nënstacionit 220/10(20)kV Drenasi dhe Linjës së Dyfishtë Transmetuese 220kV
- Ndërtimi i Nënstacionit 110/10 (20) kV Dardania (Prishtina 6) dhe Linjës së Dyfishtë Kabllore Nëntokësore Transmetuese 110 kV, linja e parë e këtij lloji në Kryeqytet.
- Zyra e Rregullatorit për Energji me 15 shkurt 2019, mori vendimi final për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST – KOSTT)
- Suksesi i radhës dhe momenti historik për KOSTT, e cila është nënshkrimi i Marrëveshjes për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK) me 26 nëntor 2019.
- Me 30 qershor 2020 u nënshkrua Marrëveshja e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E duke i hapur rrugë pavarësimit energjetik të KOSTT.
- Me datë 14 dhjetor 2020 përfundimisht KOSTT u shkëput nga Blloku SMM dhe filloi operimin e pavarur si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë (Blloku AK) duke krijuar kështu kushte të përshtatshme për shfrytëzimin optimal të burimeve gjeneruese brenda Bllokut AK.



- Për herë të parë në historinë e sektorit të energjisë të Republikës së Kosovës filloi alokimi i kapaciteteve interkonektive (ndërshtetërore) nën mbikëqyrje nga KOSTT dhe inkasimi i të hyrave nga shitja e tyre
- U funksionalizua nga aspekti komercial linja interkonektive e tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri, investim i përbashkët me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW ndërtimi i së cilës ka përfunduar që në vitin 2016.
- U themelua Bursa Shqiptare e Energjisë-ALPEX që shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë. Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri, përmes së cilit do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapaciteteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore të të dyja vendeve, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Të gjitha këto aktivitete të KOSTT janë në përputhje me objektivat strategjike, që janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
2. Mirëmbajtja dhe operimi i sigurtë dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit;
3. Krijimi i kushteve për një treg të liberalizuar dhe të integruar të energjisë elektrike;
4. Implementimi i tregut të organizuar një ditë para dhe benda ditor;
5. Implementimi i tregut balancues të energjisë elektrike;
6. Sigurimi i stabilitetit financiar të kompanisë;
7. Operimi si zonë e pavarur rregulluese/ në kuadër të bllokut AK në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale;
8. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
9. Avancimi i partneritetit me palët e interesit;
10. Të jetë punëdhënës atraktiv, duke siguruar barazinë gjinore dhe që investon në zhvillimin profesional të punonjësve, të talenteve dhe në avancimin e dijes;
11. Të jetë kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, në aspektin social dhe mjedisor;
12. Të krijojë një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune;
13. Menaxhimi i cilësisë dhe avancimi i kompanisë sipas standardeve ISO;
14. Rritja e të hyrave nga shërbimet për shfrytëzim të infrastrukturës së sistemit të telekomit dhe nga shërbimet tjera sekondare;
15. Akomodimi i kyçjeve të reja në rrjetin e transmetimit;

#### 16. Kontribuoj në mbarëvajtjen e punës për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI).

Objektivat e lartpërmendura, para së gjithash, kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT është një kompani efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Sa i përket zhvillimit të rrjetit të dhënat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 2. Zhvillimet në rrjetin e transmetimit 2018-2022

2018-2022	Njësia	2017	2022
Kapaciteti N	MW	1,700	1,800
Kapaciteti N-1	MW	1,160	1,300
Linjat 110 kV	km	842	892
Linjat 220 kV	km	232	239
Transformatorët në kufi me KEDS	MW	2,080	2,320

## 4. Shpenzimet kapitale

Të dhënat dhe arsyetimet për shpenzime kapitale do ia bashkëngjisim versionit final të Planit Investues Pesëvjeçar.

## 5. Total shpenzimet operative

Për periudhën pesëvjeçare 2018-2022, KOSTT-it i janë lejuar 36,586,685 € të hyra në emër të shpenzimeve operative, ku hyjnë shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, shpenzimet e personelit, shpenzimet e shërbimeve komunale dhe shpenzimet tjera operative.

Tabela 3. Shpenzimet e lejuara dhe shpenzimet e realizuara 2018-2022

Total Shpenzimet Operative	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Shpenzimet e Lejuara Pas Faktorit të Efikasitetit	€'000	7,423.249	7,424.537	7,281.239	7,110.334	7,347.326	36,586.685
Shpenzimet e Realizuara	€'000	6,563.709	7,166.804	8,085.643	7,524.981	7,139.699	36,480.837
Ndryshimi	€'000	859.540	257.733	(804.404)	(414.646)	207.626	105.849

Tabela 4. Total shpenzimet operative 2023-2027

Total Shpenzimet Operative	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	Total
Propozimi	€'000	10,302.180	11,271.144	11,775.228	12,344.953	13,341.936	59,035.441

Më tutje janë paraqitur të dhënat dhe sqarimet në vazhdim.

## 5.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes

KOSTT për buxhetin e mirëmbajtjes për vitet 2018-2022 ka pasur të lejuara 5,253,661 € kurse janë realizuar 3,360,342.

Tabela 5. Mirëmbajtja e lejuar dhe e realizuar 2018-2022

Shpenzimet e Mirëmbajtjes	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Lejuara	€'000	1,077.000	1,077.187	1,056.397	1,029.258	1,013.819	5,253.661
Të Realizuara	€'000	493.690	684.050	752.920	826.682	603.000	3,360.342
Ndryshimi	€'000	583.310	393.137	303.477	202.576	410.819	1,893.320

Të gjitha planet e parashikuara të mirëmbajtjes si dhe ato të paparashikuara vit për vit realizohen mbi 95%. Mirëmbajtja kryhet sipas Rregullores së Mirëmbajtjes e cila është bazuar në standarde ndërkombëtare.

Mirëpo, niveli i ulët i paraqitur në pasqyra financiare diktohet nga dy faktorë. E para është se një pjesë e mirëmbajtjes në pasqyra financiare paraqitet te stoqet dhe një pjesë tjetër te investimet kapitale. E para është për shkak se të gjitha pjesë rezervë e që janë pjesë e planit të mirëmbajtjes evidentohen si stoqe deri sa të jenë të pa aktivizuara, si dhe e dyta disa pjesë rezervë që sigurohen me buxhetin e mirëmbajtjes në rast se e tejkalojnë vlerën prej 5% të asetetit që i bashkëngjitet evidentohet si investim kapital. Këto janë dy elementet ndikuese në nivelin e raportuar të mirëmbajtjes.

Mirëmbajtja e realizuar është preventive dhe e planifikuar. Disponueshmëria e rrjetit të transmetimit është e lartë edhe përkundër rritjes së aseteve me realizimin e investimeve kapitale . Indikatorët e prishjeve dhe rënieve të elementeve të sistemit janë në nivel të ulët. Numri i intervenimeve emergjente është mjaft i vogël e që ndikon në zvogëlimin e kostos së mirëmbajtjes.

Sa i përket propozimit për mirëmbajtjen 2023-2027, ajo paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 6. Propozimi për mirëmbajtje 2023-2027

Shpenzimet e Mirëmbajtjes	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
Propozimi	€'000	1,023.813	1,188.245	1,061.245	1,144.585	1,150.585

Planin e detajuar të mirëmbajtjes mund ta gjeni të bashkëngjitur me këtë dokument.

## 5.2 Shpenzimet tjera operative

Për periudhën 2018-2022 për kategorinë e shpenzimeve tjera operative të KOSTT janë lejuar 31,313.964 € kurse janë realizuar 33,120.495 €. Ky tejkalim i shpenzimeve ka ndodhur si pasojë e nivelit shumë të ulët të lejuar për këtë kategori.

Siç mund të shihet edhe nga tabela në vazhdim aplikimi i faktorit të efikasitetit ndaj KOSTT ka dëmtuar operimin financiar të kompanisë.

Tabela 7. Shpenzimet tjera operative 2018-2022

Shpenzimet tjera operative	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Të Lejuara	€'000	6,346.249	6,347.351	6,224.843	6,062.016	6,333.506	31,313.964
Të Realizuara	€'000	6,070.019	6,482.754	7,332.723	6,698.299	6,536.699	33,120.495
Ndryshimi	€'000	276.230	(135.403)	(1,107.881)	(636.283)	(203.193)	(1,806.530)

Në këtë kategori të shpenzimeve hyjnë: shpenzimet e stafit, sigurimi shëndetësor, shërbimet komunale, udhëtimet zyrtare, trajnimet, telefoni, derivate, sigurimi fizik, furnizimi me materiale, përkthime, provizione bankare, shpenzime kadastrale, shërbime juridike, publikime, auditim, internet, kompenzim të dëmeve, paisje për mbrojtje në punë, shërbimet për CAO, shpenzimet për taksa, shpeditim, pagesa ARKEP, shpenzime përmbarimore dhe shumë shpenzime tjera.

Duke u bazuar në trendin aktual të inflacionit shpenzimet e parashikuara për këtë kategori kanë marrë parasysh një rritje për 10 % në vitin a parë për të reflektuar pjesërisht rritjen e çmimeve aktuale në treg si dhe viteve tjera një rritje e vogël për ta përcjellur trendin.

Kjo rritje është përfshirë gjithashtu me qëllim të mbajtjes së stafit profesional duke marrë parasysh se dukuria e ikjes së stafit e cila e ka përfshirë të gjithë vendin e ka prekur edhe KOSTT-in.

KOSTT ka arritur një nivel të lartë në ngritjen e cilësisë së kompanisë, parametrave teknik dhe financiar, qëndrueshmëri financiare, reputacion në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Si rezultat i kësaj KOSTT ka arritur të siguroj financim të projekteve nga donatorët dhe qasje në institucione kredibile financiare ndërkombëtare si KFW, BERZH.

KOSTT sa i përket performancës teknike, sigurisë së furnizimit, humbjeve në rrjet etj. mund të krahasohet me OST-të evropiane dhe gjithë kjo është arritur falë punës, përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të vet andaj edhe rritja e buxhetit për staf është qenësore për vazhdimin e mbajtjes dhe ngritjen e kualitetit me shërbimet që i përkasin së OST.

Tabela. 8 Shpenzimet tjera operative 2023-2027

Shpenzimet tjera operative	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	Total
Propozimi	€'000	9,278.367	10,082.899	10,713.983	11,200.368	12,191.351	53,466.968

### 5.3 Rritja e numrit të stafit

Gjatë periudhës tarifore 2018-2022 numri i përgjithshme i lejuar i stafit për KOSTT ka qenë 381.

Bazuar në rritjen e numrit të aseteve, rritjes së vëllimit të punës, kërkesa shtesë pas marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, punës si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Shqipëri – Kosovë (AK), rritjes së sigurisë kibernetike, paraqitet nevoja për rritjen e numrit të përgjithshme të punëtorëve për përdhën tarifore 2023-2027.

Arsyet kryesore për rritjen e numrit të punëtorëve për periudhën tarifore 2023-2027 janë:



- Pas nënshkrimit të marrëveshjes se kyçjes me ENTSO-e dhe operimit të pavarur si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri, janë shtuar kërkesa të reja ndërlidhur me Bllokun rregullues AK dhe me raportimin dhe plotësimin e platformave në kuadër ENTSO-E. Skedulimi dhe shkëmbimi i fajllave për sigurinë e sistemit në qendrën koordinuese (RSC) dhe TSO evropiane nga Qendra Nacionale Dispecerike. Këto kërkesa kryesisht kanë ndikim në rritjen e numrit të stafit në Operatorin e Sistemit.
- Zhvillimi i projekteve ka ndikuar në rritjen e asetëve fizike si: rritja e numrit të nënstacioneve të reja, shtimi i gjatësisë së linjave të tensionit të lartë, rritja e numrit të transformatorëve energjetike dhe stabilimenteve dhe pajisjeve tjera përcjellëse duke rritur vëllimin e punës për stafin aktual. Krahas rritjes së asetëve fizike nuk ka ndodhur edhe rritja e numrit të stafit përkatës. Rritja e asetëve kryesisht ndikojnë në rritjen e numrit të stafit të Operatorit të Transmisionit dhe Departamentit të Shërbimeve Përkrahëse në kuadër të Drejtorisë Qendrore.
- Sipas udhëzuesit për zbatimin e marrëveshjes për energji parashihet integrimi i nënstacionit 110/x kV/kV Vallaq. Integrimi i NS Vallaqit ndikon në rritjen e numrit të stafit të Operatorit të Transmisionit.
- Zhvillimi i sektorit të energjisë, përkatësisht rritja e kontratave të operatorëve dhe BRE në tregun e energjisë elektrike në Kosovë. Kjo ndikon kryesisht në rritjen e stafit të Operatorit të Tregut.
- Plotësimi i kërkesa të reja pas certifikimit me standardin ISO 27001, dhe rritja e sigurisë kibernetike. kërkesa kanë ndikim në rritjen e numrit të stafit në Departamentit të Shërbimeve Përkrahëse në kuadër të Drejtorisë Qendrore.

Tabela.9 Kërkesat për rritje të numrit të stafit

Numri i stafit i planifikuar për periudhën 2023-2027	Lejuar 2018-2022	2023	2024	2025	2026	2027
TO	220	234	239	239	239	247
SO	30	34	38	38	38	38
MO	18	18	18	19	19	19
HQ	113	118	127	127	127	127
KOSTT	381	404	422	423	423	431



## 6. Humbjet në transmetim

Sa i përket humbjeve të realizuara në raport me humbjet e lejuara KOSTT gjatë çdo procesi të përshtatjeve të rregullta ka raportuar në mënyrë të detajuar. Sa për ilustrim në vazhdim paraqitet tabela me vlera të parashikuara të kostos për periudhën 2023-2027.

Tabela 10. Humbjet e parashikuara në transmetim 2023-2027

Viti	2023	2024	2025	2026	2027
Humbjet GWh	139	129	129	130	132
Çmimi €/MWh	151	171	170	177	190
Pagesa e humbjeve (€'000)	21,058	22,059	21,981	23,055	25,040

## 7. Shërbimet Ndhmëse

Tabela 11. Shërbimet ndihmëse 2023-2027

Shërbimet ndihmëse 2023-2027	2023	2024	2025	2026	2027
Kostoja totale '000€	13,000.000	15,000.000	18,000.000	18,000.000	18,000.000

Aktualisht KOSTT në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes me RGCE\ENTSO-E, është duke operuar si LFC Zonë e pavarur. Në kontekst të kësaj, ENTSO-E në vazhdimësi do të monitoron përmbushjen e kushteve teknike të KOSTT për operim të pavarur si LFC Zonë (LFC Area).

Një nga kërkesat me prioritet të lartë është sigurimi i shërbimeve ndihmëse për të balancuar sistemin elektroenergetik të Kosovës në kohë reale.

Bazuar në përshkrimet e cekura më lart KOSTT obligohet që të siguroj blerjen e shërbimeve ndihmëse për balancimin e sistemit, konkretisht:

1. Rregullimin terciar (+/- mFRR Manual Frequency Restoration Reserves):

KOSTT është i obliguar të siguroj rregullimin terciarë për ngritje (+mFRR – pozitive Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën +150 MW dhe rregullimin terciarë për zbritje (-mFRR – negativ Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën -30 MW, sasi këto që nevojiten për balancimin e SEE të

Kosovës me rastin e paraqitjes së mungesave dhe tepricave të en.el. në SEE të Kosovës.

Kalkulimi për kostot e kapacitetit për rregullimin terciar mFRR në ngritje (150 MW) dhe zbritje të kapacitetit prej (-30 MW), si dhe rregullim sekondar aFRR +/-25MW (Automatic Frequency Restoration Reserves), për vitin 2023 është paraqitur si në tabelën e mëposhtme, gjithashtu edhe vitet në vijim janë llogaritur në të njëjtën mënyrë.

Tabela 12. Kostoja e shërbimeve ndihmëse 2023

Muaji	Kapacitet i (MW)	Ditë/Muaj	aFRR ngritje (çmimi 16.37 €)	aFRR zbritje (çmimi 10.0 €)	mFRR ngritje (çmimi 5.0 €)	mFRR zbritje (çmimi 2.4 €)	Gjithsej
Janar	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	53,568.00 €	1,102,067.16 €
Shkurt	25	28	275,031.50 €	168,000.00 €	504,000.00 €	50,400.00 €	997,431.50 €
Mars	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Prill	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Maj	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Qershor	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Korrik	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Gusht	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Shtator	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Tetor	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
Nëntor	25	30	294,676.60 €	180,000.00 €	540,000.00 €	54,000.00 €	1,068,676.60 €
Dhjetor	25	31	304,499.16 €	186,000.00 €	558,000.00 €	55,800.00 €	1,104,299.16 €
<b>Total</b>			<b>3,585,232.02 €</b>	<b>2,190,000.00 €</b>	<b>6,570,000.00 €</b>	<b>654,768.00 €</b>	<b>13,000,000.02 €</b>

## 8. Fondi për BRE

Fondi për BRE është trajtuar ndaras nga të hyrat e KOSTT duke u bazuar në faktin se ky fond nuk vetëm menaxhohet nga KOSTT dhe nuk është e hyrë e vet. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat e realizuara si dhe parashikimet për 5 vitet e ardhshme.

Tabela 13. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit 2018-2022

Fondi për BRE Realizimi	2018	2019	2020	2021	2022
Të hyrat €'000	10,114.934	18,289.389	25,046.069	29,662.300	42,682.000
Fondi €'000	9,026.350	15,673.593	18,637.785	23,129.250	38,364.000
Ndryshimi €'000	1,088.584	2,615.795	6,408.284	6,533.050	4,318.000

Tabela 14. Parashikimet për Fondin e BRE 2022-2027

Fondi për BRE Parashikimi	2023	2024	2025	2026	2027
Fondi €'000	47,939.695	50,336.680	120,710.885	152,331.655	371,603.448

## 9. Përfundim

Në tabelën në vijim është paraqitur përmbledhja e kërkesave për kostot operative të KOSTT, për periudhën e tretë rregullative 2023-2027.

Tabela 15. Kërkesa për kostot operative 2023-2027

Kërkesa për kostot operative 2023-2027	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027	2023-2027
Mirëmbajtje	€'000	1,023.813	1,188.245	1,061.245	1,144.585	1,150.585	5,568.473
Shpenzime tjera operative	€'000	9,278.367	10,082.899	10,713.983	11,200.368	12,191.351	53,466.968
Humbje	€'000	21,058.460	22,059.000	21,981.210	23,054.750	25,040.293	113,193.713
Shërbime ndihmëse	€'000	13,000.000	15,000.000	18,000.000	18,000.000	18,000.000	82,000.000
Total	€'000	44,360.640	48,330.144	51,756.438	53,399.703	56,382.229	254,229.155

Duke marrë parasysh rëndësinë e KOSTT si nyje e sektorit elektroenergetik të Kosovës, operimi efikas dhe i pavarur është i domosdoshëm i cili lidhet ngushtë me aprovimin e këtyre kërkesave.